

FJALA E DEPUTETIT NIKO PELESHI

E HËNË 30 MAJ 2022

Jam i bindur se askush nuk ka kuptuar asgjë. Ndjesë! Nxorët një video që tregon një të vërtetë, të cilën ne e themi me krenari: po, baza e Kuçovës sot është certifikuar, pra është kthyer në një bazë taktike ajrore e NATO-s. Natyrisht, është në ndërtim, brenda dy vjetësh do të jetë operative dhe është një zhvillim dhe një ngjarje shumë pozitive për sigurinë tonë kombëtare, por edhe për sigurinë rajonale, sidomos pas agresionit të fundit rus, i cili e ka ndryshuar, siç e dimë, skenën e sigurisë. Kur ka filluar kjo iniciativë, nuk është se e dinim që do të mbërrinim këtu, por sot që e kemi këtë bazë, ashtu si jo shumë vende në rajon, natyrisht jemi krenarë që është një arritje e kësaj kohe, është një arritje e Shqipërisë dhe, padyshim, e kësaj qeverie, e cila ka ditur të bashkëpunojë me strukturat euro-atlantike, me NATO-n, Aleancën ku bëjmë pjesë, dhe po e bëjmë tani realitet.

Megjithatë, edhe në fjalën e Kryeministrit, edhe në fjalët e mia, në raport me zhvillimet në Forcat e Armatosura, ne nuk u vëmë shumë mbiemra politikë këtyre zhvillimeve, sepse nuk kanë lidhje as me njërin mandat qeverisës, as me një parti të caktuar, por kanë lidhje me sigurinë tonë kombëtare. Kështu që më vjen keq që spekuloni. E gjithë interpelanca është spekulative dhe e them që në fillim. Thatë se ka mungesë transparence dhe nuk e shpjeguat çfarë do të thotë, pse? Ke të drejtë të thuash se ka mungesë transparence, nëse ke kërkuar informacion dhe nuk ke marrë përgjigje. A ka pasur ndonjë rast kur ju si deputet apo si anëtar i Komisionit të Sigurisë keni kërkuar informacion lidhur me këto çështje apo me çështje të tjera dhe nuk keni marrë përgjigje? Pra, nuk keni të drejtë të thoni se nuk ka transparencë. Tani, dy-tri fjalë për të kuptuar se për çfarë po flasim.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, siç e dini, trashëgojnë asete të një ushtrie gjigantomane të para viteve '90, realitet i cili ka ndryshuar, por nuk është kollaj të ndryshojë në raport me pronat e ushtrisë. Pra, ne nuk kemi problemin që ju po mendoni të shisni dhe të aludoni në opinion, se me pronat e ushtrisë po bëhet nami. E kundërta është e vërtetë. Sot që flasim, ne kemi 1372 prona në administrim të Forcave të Armatosura, të Ministrisë së Mbrojtjes, nga të cilat 1193 janë vënë në dispozicion të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, pra në dispozicion të zhvillimit, sepse nuk mund t'i mbajmë dot, nuk na duhen, nuk janë në mundësitë tona për t'u shtrirë, për t'u përhapur, për t'u vendosur në një numër të tillë pronash. Bëhet fjalë për një Forcë të Armatosur, e cila është tkurrur pas viteve '90, me shumë të drejtë, me më shumë se dhjetëfish.

Nga një kohë kur i gjithë populli ishte ushtar dhe ushtria ishte gjithandej, jemi në një kohë tjetër. Jemi pjesë e Aleancës së NATO-s, kemi një forcë të armatosur më të vogël, fleksibile, operacionale, sipas kërkesave të aleatit tonë NATO, por na duhet që këtë numër të madh pronash ta vëmë në eficiencë dhe të mos e mbajmë thjesht nën vëzhgim. Nëse ne do të vendosnim vetëm një ushtar në turn në 1372 prona, do të na duhej e gjithë ushtria, ku e gjithë forca e armatosur të angazhohej vetëm me ruajtjen e këtyre pronave. Pra, çështja e dhënies së pronave në përdorim të të tretëve, të privatëve, të investitorëve, nuk është një herezi, nuk është një mëkat, nuk është një paligjshmëri, por është një detyrë që na e ka caktuar ligji, Kushtetuta dhe kuadri ligjor.

Tani, unë kam një periudhë relativisht të shkurtër si ministër dhe për të ta rrëzuar komplet spekulimin që do të bësh, nuk kam dhënë asnjë pronë me qira, nuk kam privatizuar asnjë pronë, në kuptimin që nuk kam dhënë miratimin për asnjë pronë. Por nuk mburrem me këtë. Kjo nuk është certifikatë, nuk është fletë-lavdërimi. Pse? Sepse një ministër Mbrojtjeje, së bashku me një ministër Financash dhe Ekonomie, dhe një qeveri do të quhet se e ka bërë mirë punën, kur arrin t'i vërë në eficiencë pronat për zhvillim, ato që janë të lira dhe, natyrisht, ta vendosë sa më mirë forcën e armatosur në ato prona që ne i quajmë Plani i Vendosi dhe i Përhapjes, që, siç e thatë ju, me shumë të drejtë, është një plan i cili hartohet nga Shtabi, propozohet nga ministri i Mbrojtjes dhe miratohet nga Presidenti, në cilësinë e komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Siç e thatë ju, në vitin 2014 ka dalë dekreti i fundit i Planit të Përhapjes, ndërkohë që nga viti 2014 nuk kemi asnjë pronë të dalë apo të futur në Planin e Vendosi dhe të Përhapjes, sepse nuk ka pasur një dekret tjetër të Presidentit që nga ajo kohë. Për të gjitha pyetjet e tjera, të cilave do t'u përgjigjem një nga një, në disa prej tyre ju e ngrinit pyetjen: "Janë apo jo në plan? A është respektuar apo jo plani?" Po ju përgjigjem me një fjali: të gjitha pronat që kanë qenë në planin e përhapjes janë në planin e përhapjes dhe asnjë pronë nuk ka dalë nga plani i përhapjes, sepse nuk ka asnjë dekret tjetër presidenti pas vitit 2014. Thatë se ligji "Për kthimin e pronave" e ndalon kthimin e tyre brenda planit të përhapjes, pra brenda listës së pronave, që janë të planit të vendosjes dhe të përhapjes.

Ky është thelbi i problemit... Tani, unë nuk dua ta politizoj, por po e them, në kohën kur qeveriste një parti tjetër para vitit 2013, janë bërë kthime pronash, me vendim gjykate apo nga Komisioni i Kthimit të Pronave, në bazat tona detare. Dhe kjo lidhet me një nga pyetjet tuaja për bazën e Shëngjinit. Komisioni i Kthimit të Pronave dhe gjykatat kanë dhënë prona në mes të bazës, mbi mol, dhe aty ka filluar problemi që kemi sot, ku jemi nëpër prokurori e gjykata për një ndërtim për të cilin thonë: "Unë e kam pronën e kthyer, e kam blerë nga një ish-pronar, ia ka dhënë gjykata. Ne themi që kjo është bazë, është

në planin e përhapjes dhe duhej të ishte regjistruar në emrin tonë.” Hipotekat (Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme) të partisë suaj në pushtet, në vitin 2009, kanë regjistruar brenda planit të përhapjes pikërisht atë pronë për të cilën ju flisni.

Nuk mund të nxjerr harta këtu, sepse po e them që ta kini parasysh edhe ju, plani i vendosjes dhe i përhapjes është sekret shtetëror. Nuk mund të japësh detaje, sepse është i klasifikuar. Ndaj duhet të respektoni ligjin për trajtimin e informacionit të klasifikuar, nëse ju dhe unë nuk duam të biem në konsumimin e një ndonjë vepre penale, që është nxjerrja e informacionit të klasifikuar. (Ndërhyrje pa mikrofon) Po i marr me radhë. Pyetja e parë, e cila lidhet me dhënien e një toke me qira në vitin 2016, është: “Cili është statusi i pronës nr. 1018, ish-vend dislokimi i shtabit të vjetër të bazës ajrore Kuçovë-Berat, të dhënë me qira nëpërmjet VKM-së nr. 562, datë 29.07.2016, në përputhje me listën e pronave në planin e vendosjes dhe të përhapjes, miratuar nga komandanti i Përgjithshëm në vitin 2014”? Përgjigjja është si vijon.

E para, kjo pronë nuk ka qenë në planin e përhapjes, por ka qenë pronë e lirë, pra një pronë në listën e pronave që i janë transferuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Ministrisë së Ekonomisë së kohës) për t’u vënë në dispozicion të zhvillimit. E dyta, është dhënë pas shprehjes së interesit të një kompanie, së cilës nuk po ia them emrin thjesht për të qenë korrektë dhe për të mos marrë nëpër gojë emra kompanish, në dijeninë time, izraelite apo izraelito-shqiptare, e cila ka shprehur interesin asokohe te Ministria e Financave dhe Ekonomisë për ta marrë me qira. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe me këtë rast po shpjegoj edhe procedurën se si veprohet (nuk është një pronë që e jep ministri apo Kryeministri, por ka një procedurë): kërkesa vjen te Ministria e Mbrojtjes, ministria e çon te Shtabi i Përgjithshëm, ky e shtron për diskutim te komanda përkatëse (në këtë rast te komanda e forcës ajrore).

Në rast se komisioni aty gjykon se kjo pronë nuk është në planin e përhapjes, pra në kuptimin se nuk ka funksionalitet, nuk i duhet, është lënë pronë e lirë për zhvillim dhe nuk është as në planet e zhvillimit të afërm apo të mesëm të Forcave të Armatosura, jep okejin, pra jep no objection, jep miratimin për të vazhduar sipas ligjit me procedurat e qiradhënies. Prona në fjalë, me sa kam lexuar, është dhënë me kontratën simbolike “1 euro”, për shkak se bëhet fjalë për një investim që me sa duket i ka kënaqur kërkesat e kontratës simbolike “1 euro”. Tani, problematika këtu është se nga ai vit dhe deri sot, dhe këtu keni të drejtë ta ngrini si shqetësim, të cilin e kam edhe unë shqetësim, e kemi të gjithë, nuk ka ndodhur investimi. Cili është roli i Ministrisë së Mbrojtjes? Komanda e Forcës Ajrore në kontratën e lidhur ndërmjet të dyja palëve, që është Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe investitori (nuk jemi ne palë, sepse nuk jemi pronarë, por administratorë), Komanda e Forcës Ajrore...

Ndjesë! Komanda e Forcës Ajrore ka detyrimin, sipas kontratës, të bëjë monitorimin. E ka bërë më së miri detyrën, i kam këtu të gjitha, ka bërë akt monitorimi çdo vit sipas kontratës, ka konstatuar që investimi nuk ka filluar dhe i ka rekomanduar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ta prishë kontratën, për shkak se në gjykimin tonë kontrata duhet prishur, pasi nuk janë përmbushur detyrimet e kontratës. Pastaj, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nga ana e saj, natyrisht, menaxhon kontratën dhe e çmon vetë nëse është në kushtet e prishjes së kontratës apo është në kushtet e shkaqeve të justifikuar për shtyrje afati e të tjera. Për shembull, unë di se kjo kompani ka pretenduar për shkaqe si pandemia ose mosmarrja e lejes së ndërtimit e të tjera.

Nuk po e justifikoj, nuk e di, nuk kam pse ta di, madje nuk është detyra ime ta di, nëse jemi në kushtet kur duhet prishur kontrata apo jo, pasi Ministria e Mbrojtjes nuk është palë në kontratë dhe nuk ka këtë detyrë. Ama, sugjerimin e kemi bërë, sepse kemi konstatuar me akte monitorimi që investimi nuk ka filluar. Kaq është e gjithë historia me këtë pronë dhe kjo ishte përgjigjja. Për sa i përket pyetjes së dytë, që lidhet me ish-Bazën Ndihmuese në Shëngjin, nëse vijon të jetë në planin e vendosjes dhe përhapjes, të miratuar nga komandanti i Përgjithshëm në vitin 2014, prona nr. 1311, ish- Baza Ndihmuese Shëngjin, Lezhë, ndarë nga prona nr. 974, Baza Ndihmuese Shëngjin, Lezhë, me VKM 20, datë 21.03.2017, përgjigjen e dhashë më sipër: po, është në planin e përhapjes, sepse nga viti 2014 plani i përhapjes nuk ka ndryshuar.

Ai është dekreti i fundit i Presidentit për planin e përhapjes. Ama problematika në këtë zonë është vërtet shumë e madhe. E thashë edhe pak më sipër. Mbi Bazën e Shëngjinit ka pasur kthime pronash, kafshime të tmerrshme të pronës, të cilat, ndonëse ne nga njëra anë (kur them “ne” e kam fjalën për Ministrinë e Mbrojtjes) në vitet 2003, 2004, 2005 kërkonim regjistrimin, zyrat e regjistrimit të pasurive të patundshme nuk e regjistruan asnjëherë në favor të ministrisë, por në vitin 2009 e regjistruan në emër të privatit. Nuk dua të gjykoj nëse e ka pasur apo jo pronën, por ju e cituat ligjin e kthimit dhe kompensimit të pronave, i cili ndalon kthimin e pronave kur ato bien mbi baza apo prona, të cilat i ka në përdorim Ministria e Mbrojtjes. E di që ju mund të distancoheni dhe ju doli rasti të distancoheni nga e kaluara, kjo është çështja juaj, por ky është realiteti. Çfarë kemi bërë ne është ajo që duhet të bënim sipas ligjit. Ne kemi bërë dy kallëzime administrative, por çështjet janë pushuar.

Gjithashtu, kemi bërë tre kallëzime penale, por në dy kallëzimet e para penale prokurori e ka pushuar çështjen. Për këtë arsye ne kemi bërë ankim në gjykatë ndaj prokurorit. Pra, kemi çuar edhe prokurorin në gjykatë për vendim të padrejtë. I fundit është një vendim i drejtësisë së re, SPAK-ut, sepse e kemi çuar atje, për ndërtimin që po bëhet brenda bazës, i cili ka vendosur sekuestro preventive. Ky ndërtim

po bëhet me leje ndërtimi, sepse pronën e kthyer padrejtësisht kompania e kishte blerë nga ish-pronari. Kompania ka aplikuar për leje ndërtimi dhe ka marrë leje ndërtimi nga kryetari i bashkisë, përfaqësues i Partisë Demokratike, në vitin 2009, i cili më pas ia ka rifreskuar lejen në vitin 2018 dhe më pas në vitin 2019.

Nuk dua t'ia përmend emrin kryetarit, por në atë kohë mbante kostumin e Partisë Demokratike, nëse doni të luani dhe spekuloni politikisht. Ne nuk mund të bëjmë vetëgjyqësi ndaj gjithë kësaj historie, por ne kemi shkuar në gjykatë dhe në prokurori, ku kemi bërë pesë kallëzime, dy administrative dhe tre penale. Se çfarë mund të bënit ju, po të ishit në vendin tim, më shumë se kaq, mund të na e thoni kur të konsumoni tri minutat tuaja. Për sa i përket pyetjes së tretë: a është ndjekur procedura e parashikuar nga ligji nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe komandimit të Forcave të Armatosura" për dhënien me qira të të gjithë sipërfaqes së Bazës Detare në Sarandë, prona nr. 696, Baza Ndhmuese Limion, Sarandë, me sipërfaqe 39446 metra katrorë, pronë në listën e pronave në planin e përhapjes dhe vendosjes së miratuar nga Komandanti i Përgjithshëm në vitin 2014, e para, të gjitha pronat që kanë qenë në vitin 2014 në planin e përhapjes vazhdojnë të jenë dhe sot.

Pra, edhe kjo pronë vazhdon të jetë në planin e përhapjes. E dyta, për sa i përket pyetjes nëse është ndjekur procedura e parashikuar nga ligji nr. 64 "Për pushtetet dhe autoritetet", ky ligj nuk parashikon procedura për trajtimin, transferimin dhe dhënien me qira, por ka vetëm një fjali. Ky ligj thotë: "Plani i përhapjes miratohet nga Presidenti". Për sa u përket procedurave të trajtimit të pronave, të gjitha pronat e pronarit Republika e Shqipërisë trajtohen sipas VKM-së nr. 54 të vitit 2014. Pra, edhe në këtë rast, sipas ligjit, është ndjekur ajo procedurë. Po të doni, mund ta përsëris si shprehet interesi te Ministria e Financave. Ministria e Financave dhe Ekonomisë e sjell në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministria e Mbrojtjes e çon në shtab, shtabi te komanda përkatëse, që në këtë rast është Komanda Detare, kurse Komanda Detare ka analizuar kërkesën dhe i ka kërkuar Ministrisë së Ekonomisë që, kur të negociojë kontratën me investitorin, t'i kërkojë investitorit të investojë pro bono ndërtimin e një baze ndihmuese të re, në kuptimin e një pankine të re, dhe të gjithë infrastrukturës mbështetëse të saj.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, kur ka lidhur kontratën, ka vendosur një nen (neni 9, në mos gaboj), ku detyron investitorin të ndërtojë për interes të Forcës Detare pankinën dhe të gjithë infrastrukturën mbështetëse. E di që do të pyesni "pse e keni vonuar 1 vit dhënien e aksesit të investitorit", prandaj po ju them se e kemi vonuar një vit, sepse donim të garantoheshim që investitori do t'i përmbushte kushtet e kontratës dhe do të kënaqte të gjitha kërkesat operationale të Forcës Detare. Është bërë projekti, është diskutuar në Forcën Detare dhe është miratuar. Nëse doni të dini më

shumë detaje, unë si ministër kam dërguar drejtorinë e Inspektimit për të pasur një vlerësim të dytë dhe kjo drejtori më ka thënë që projekti duhet rishikuar edhe një herë për të përmbushur edhe më mirë kërkesat e Komandës Detare.

Komanda Detare e ka rishikuar projektin, ka shtuar disa infrastruktura të tjera, ka bërë amendimin e kontratës të Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe i është dhënë aksesi. Unë kam nxjerrë një urdhër, sipas të cilit, në pikën 6 të tij, thuhet që do të jepet aksesi, por jo dorëzimi përfundimtar i pronës. Dorëzimi përfundimtar i pronës do të bëhet vetëm pasi investitori të ketë ndërtuar bazën e re siç ka kërkuar Komanda e Forcave Detare. Kjo është historia e këtij investimi. Për sa i përket pyetjes tjetër, që ishte e përgjithshme, nëse ka pasur shkelje apo jo, unë nuk jam as gjyqtar e as prokuror, por drejtoj një institucion kushtetues dhe, natyrisht, operoj me mekanizma dhe institucione sipas ligjit.

Kjo do të thotë se vlerësimet ka apo jo shkelje i bëjnë auditet e brendshme, auditet e jashtme, Kontrolli i Lartë i Shtetit, komisionet hetimore parlamentare, gjykata, prokuroria e të tjera. Unë ju siguroj vetëm për një gjë: sa herë që nga auditet i brendshëm, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo nga vendime gjykatash dhe hetime prokurorie do të ketë konstatime shkeljesh, unë nuk do të qëndroj asnjëherë në mosveprim, por do të veprojmë, siç ligji më detyron. Shumë faleminderit!